



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Nr. 158 prot.

Kamëz, më 19.12 2018

V E N D I M


Nr. 146, datë 19/12 2018

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA TË AMBIENTEVE BRENDA
PALLATIT TË KULTURËS TË LLOJIT “NDËRTESE”, ME SIPËRFAQE 110 (80+30)
(NJËQIND E DHJETË) M², NË PRONËSI TË BASHKISË KAMËZ**

Këshilli Bashkiak Kamëz, i mbledhur më datë 19/12/2018, pasi mori në shqyrtim Projekt-Vendimin nr. 112, datë 11/12 /2018, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronja “c”, nenit 54, shkronja “e” dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 28, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 775, datë 05.09.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi osë në përdorim të Bashkisë Kamëz”, Kreut II, të vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar, Udhëzimi nr.13, datë 26.04.2018 “Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”, Këshilli Bashkiak Kamëz,

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të dhënies me qira për një periudhë prej 10 vjet të ambienteve brenda Pallatit të Kulturës të llojit “Ndërtesë”, me sipërfaqe 110 (80+30) m², zona kadastrale 2066, Kamëz në pronësi të Bashkisë Kamëz sipas Vendimit nr.12, datë 28.04.2009 të KRRT-së, Bashkia Kamëz, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, si dhe për lidhjen e kontratës së qirasë.

Bilbil BAJRAKTARI

KRYETAR

